



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVO



Date: 09.07.2015

Agj.nr. _____

Prishtinë

REPUBLIKA E KOSOVËS		REPUBLIKA KOSO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS		VRHOVNI SUD KOSOVA
G.J.A.-S.U.A		216/2015
Dt:		10.07.2015
PRISHTINË - PRIŠTINA		

Kolegjiumi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në Mbledhjen e Përgjithshme, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 09.7.2015, miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

1. Për mënyrën e pagesës së dënimit me gjobë, qoftë kur ai është shqiptuar si dënim i vetëm apo së bashku me dënimin me burgim, pa përjashtim vlejnë dispozitat e nenit 46 të KPPK-së. Gjykata, në situatën kur i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i ka në dispozicion katër alternativa të mundshme të veprimit dhe do e zbatojë atë alternativë që është caktuar në dispozitivin e aktgjykimit, (neni 46. par. 2, 3, 4, dhe 5 i KPK-së).
2. Gjykata duhet në dispozitiv të aktgjykimit të caktojë saktë mënyrën e ekzekutimit të dënimit me gjobë, kur i pandehuri nuk mund ta paguajë apo kur nuk dëshiron ta paguajë atë.
3. Kur gjykata të pandehurit i ka shqiptuar dënimin me gjobë, qoftë si dënim alternativ për një vepër penale (kur ligji parasheh dy dënime kumulative), apo si dënim kryesor

për bashkim veprash penale (njërin dënim me burgim e tjetrin dënim me gjobë), me rastin e zëvendësimit të këtij dënimi, me dënim me burgim, nuk aplikohen dispozitat e nenit 80. Par. 2. pika 2.2. e KPK-së, për shqiptimin e dënimit unik.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, në Gjykatën Supreme ka adresuar këto pyetje:

1. Dënimi me gjobë i shqiptuar së bashku me dënim me burgim, a mund të zëvendësohet me dënim me burgim, nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e lënë, dhe
 2. Nëse edhe ky dënim me gjobë mund të zëvendësohet me dënim me burgim, a duhet të aplikohen dispozitat e nenit 80-të të KPK-së, përkatësisht, se a duhet të shqiptohet një dënim unik me burgim.
- Lidhur me pyetjet e parashtruara jap këtë:

Dispozitat e nenit 80-të të KPK-së, aplikohen për shqiptimin e dënimit për bashkim veprash penale dhe sipas këtij neni, nëse kryesi me një apo me më shumë veprime kryen disa vepra penale, për të cilat gjykohet në të njëjtën kohë, gjykata së pari shpall dënime për secilën nga këto vepra, e pastaj për të gjitha këto vepra e shqipton dënimin unik.

Sipas nenit 80. par. 2. pika 2.2 të KPK, nëse për secilën prej veprave penale, gjykata ka shqiptuar dënimin me burgim, dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej njëzet e pesë (25) vjetësh. Kjo dispozitë aplikohet vetëm kur kemi të bëjmë me bashkim veprash penale dhe vetëm nëse gjykata me rastin e gjykimit të pandehurit i ka caktuar dënime me burgim, e që do të thotë se dispozitat për shqiptimin e dënimit unik me burgim nuk aplikohen, jo vetëm kur gjykata për një vepër penale i ka shqiptuar dy dënime kumulative; njërin me burgim dhe tjetrin me gjobë, por edhe atëherë kur gjykata për dy vepra penale të ndryshme, për njërin i ka caktuar dënim me burgim, për tjetrën dënim me gjobë, ndërsa i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë dhe këto dënime i zëvendësohen me dënim me burgim.


Edhe në situatën kur gjykata për një vepër penale të akuzuarit i ka shqiptuar kumulativisht dënim me burgim dhe me gjobë, edhe atëherë kur gjykata të akuzuarit për dy vepra penale në bashkim, për njërin i ka shqiptuar dënim me burgim, për tjetrën dënim me gjobë, ndërsa i akuzuari

nuk i ka paguar dënimet me gjobë, me rastin e zëvendësimit të këtyre dënimeve sipas nenit 46. të KPK-së, nuk aplikohen dispozitat e nenit 80. par. 2. pika.2.1. dhe i akuzuari mbanë në tërësi - kumulativisht dy dënime me burgim, njërin të shqiptuar me aktgjykim dhe tjetrin e zëvendësuar me aktvendim.

Dispozitat për shqiptimin e dënimit unik, aplikohen vetëm në dy situata edhe atë në: Situatën nga neni 80-të dhe nga neni 82, i KPK, por jo edhe atëherë, kur dënimi me gjobë zëvendësohet me dënim me burgimi, nga neni 46. par. 3 i KPK-së.

Dënimi unik shqiptohet vetëm me aktgjykim, jo me aktvendim. I akuzuari dënimin me gjobë të zëvendësuar me dënim me burgim, mund ta paguajë në çdo kohë edhe kur ka filluar ta mbajë këtë dënim, dhe në situata të tilla ndërpritet mbajtja e mëtejme e dënimit me burgim, ndërsa kjo nuk mund të ndodh sikur t'i shqiptohet dënim unik burgimi.

Prof. Dr. Fejzullah Hasani



Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës